



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.6.2023

Nr: 652

Ora: 09:30

VENDIM
PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
PËRMET, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 86, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Përmet. Kundër vendimit të sipërcituar të KZAZ-së është administruar kërkesa ankimore nr. 68, datë 20.5.2023, me ankues subjektin zgjedhor partia “Aleanca Demokristiane e Shqipërisë”, me objekt kundërshtimin e vendimit nr. 86, datë 16.5.2023, të KZAZ nr. 76, për Këshillin Bashkiak Përmet.

Më datë 24.5.2023, në seancë publike Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve shqyrtoi kërkesën ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 68, datë 20.5.2023.
2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 86, datë 16.5.2023, të KZAZ nr. 76, Bashkia Përmet.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përlllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për Këshillin e Bashkisë Përmet për subjektet zgjedhore pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim:

Data: 2.6.2023 Nr: 652
Ora: 09:30



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Përmet, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

(Tabela nr. 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	479	8,20 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2183	37,35 %
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	119	2,04 %
4	Partia Republikane Shqiptare	146	2,50 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	273	4,67 %
6	Partia Demokracia Sociale	84	1,44 %
7	Aleanca Liberale e Djathtë	112	1,92 %
8	Partia Socialdemokrate	525	8,98 %
9	Partia Demokratike	278	4,76 %
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	177	3,03 %
11	Fryma e Re Demokratike	215	3,68 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	229	3,92 %
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	91	1,56 %
26	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	364	6,23 %
33	Partia Ora e Shqipërisë	206	3,52 %
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	242	4,14 %
40	Ardhmëria Shqiptare	122	2,09 %
	Totali	5845	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Përmet, në bazë të shkresës me nr. 198/1 Prot., datë 27.2.2023 të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Herësit e përfitur nga ky pjesëtim pasqyrohen në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfitur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr.3, në vijim:

(Tabela nr. 3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	2183	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1091	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	727	Partia Socialiste e Shqipërisë
4	545	Partia Socialiste e Shqipërisë

5	525	Partia Socialdemokrate
6	479	Bashkë Fitojmë
7	436	Partia Socialiste e Shqipërisë
8	364	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane
9	363	Partia Socialiste e Shqipërisë
10	311	Partia Socialiste e Shqipërisë
11	278	Partia Demokratike
12	273	Partia Lëvizja e Legalitetit
13	272	Partia Socialiste e Shqipërisë
14	262	Partia Socialdemokrate
15	242	Partia Socialiste e Shqipërisë

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar në tabelën nr.3.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim:

(Tabela nr. 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	1
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	9
3	Partia Lëvizja e Legalitetit	1
4	Partia Socialdemokrate	2
5	Partia Demokratike	1
6	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	1

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përlllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Përmet, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	1
Partia Socialiste e Shqipërisë	9
Partia Lëvizja e Legalitetit	1
Partia Socialdemokrate	2
Partia Demokratike	1
Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Përmet, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1. Elton Xhafer Ismaili

Partia Socialiste e Shqipërisë

1. Edvin Ylli Tuçi
 2. Anila Kristul Dhimitri
 3. Elison Sulejman Xhamollari
 4. Nertila Ndreko Nebiaj
 5. Agim Ylli Andoni
 6. Entela Stefan Ibrahim
 7. Sokrat Vangjel Kondili
 8. Anida Qamil Hajredini
 9. Agathokli Misto Proko

Partia Lëvizja e Legalitetit

1. Armando Nonda Tatazi

Partia Socialdemokrate

1. Redi Kujtim Hoxha
 2. Adelina Mikail Skrapalliu

Partia Demokratike

1. Elton Shkelqim Hysenshahaj

Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane

1. Ganimeta Ibrahim Tafani

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Bashkia Përmet, herësit

Tabela nr. 2

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	
1	Bashkë Fitojmë	BF	479	239	159	119	95	79	68	59	53	47	43	39	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	2183	1091	727	545	436	363	311	272	242	218	198	181	
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	P.A.A	119	59	39	29	23	19	17	14	13	11	10	9	
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	146	73	48	36	29	24	20	18	16	14	13	12	
5	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	273	136	91	68	54	45	39	34	30	27	24	22	
6	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	84	42	28	21	16	14	12	10	9	8	7	7	
7	Aleanca Liberale e Djathtë	ALD	112	56	37	28	22	18	16	14	12	11	10	9	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	525	262	175	131	105	87	75	65	58	52	47	43	
9	Partia Demokratike	PDSH	278	139	92	69	55	46	39	34	30	27	25	23	
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	LZHK	177	88	59	44	35	29	25	22	19	17	16	14	
11	Fryma e Re Demokratike	FRD	215	107	71	53	43	35	30	26	23	21	19	17	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	229	114	76	57	45	38	32	28	25	22	20	19	
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	91	45	30	22	18	15	13	11	10	9	8	7	
26	Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane	ABDE	364	182	121	91	72	60	52	45	40	36	33	30	
33	Partia Ora e Shqipërisë	P.O.SH	206	103	68	51	41	34	29	25	22	20	18	17	
38	Partia Aleanca Demokristiane e Shqipërisë	ADK	242	121	80	60	48	40	34	30	26	24	22	20	
40	Ardhmëria Shqiptare	PASH	122	61	40	30	24	20	17	15	13	12	11	10	